

Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 17.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.09.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “EOR GROUP SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. të Prok: 616 21 3844 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Eor SHPK”, të dt. 15.09.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. 616 21 3844 121 Nr. Brendshëm **616-21-106-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 13.09.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin e prokurimit* sipas Njoftimit të datës 13.09.2021;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “ EOR shpk” me datë 13.09.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. 616 21 3844 121 Nr. Brendshëm **616-21-106-1-2-1**,

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.09.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

-Pretendimet lidhur me dorëzimin e dëshmimeve sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues nuk janë të bazuara. Edhe pse të gjitha janë sqaruar në Vendimin paraprak bazuar në pretendimet tuaja i sqarojmë prap si vijon:

-Nuk ka asnjë dëshmi as në tenderin tuaj e as në sqarimet e dorëzuara se Eneaelectronics është distributor i autorizuar i prodhuesit "Yamaha" edhe për Kosovë, por vetëm për Shqipëri dhe kjo është arsyeja pse në "autorizimin" e lëshuar nga e njejtja është shënuar se kompania nga Kosova mund të blejë vetëm produktin pianino dhe atë ka të drejtë t'ia shes blerësit tjetër, d.t.th. një të drejtë që mund ta ketë edhe çdo blerës tjetër dhe nga çdo OE-ik që nuk ka autorizim;

-Lidhur me pretendimin se keni dëshmi të autorizimit nga Nikon Holandë e kemi sqaruar në Vendimin paraprak, respektivisht kemi cekur se "Autorizimi" i dorëzuar nga ju nuk ka të shënuara asnjë nga elementet kyçe të Autorizimit, por realisht është një konfirmim për Policinë e Kosovës pa asnjë shënim për distributorin, respektivisht pa asnjë të dhënë për të autorizuarin. Poashtu shkresa nga Bashkim Mula që e keni dorëzuar si dëshmi është vetëm deklarim i tij pa asnjë të dhënë nga prodhuesi dhe pa asnjë dëshmi për rolin dhe cilësinë e tij në këtë proces. Është poashtu e pakuptueshme si pretendoni se mbishkrimi i një lokali afarist mund të trajtohet si dëshmi e autorizimit, kur mbishkrimet në Kosovë mund ti vendos secili me përmbajtje çfarë të doj vetë;

-Pretendimin se paisja e ofruar nuk i plotëson kërkesat teknike sepse nuk është cekur se me cilin lloj nga katalogu ka ofertuar, poashtu nuk qëndron sepse komisioni profesional i vlerësimit dhe tenderuesi janë të vetëdijshëm se furnizimi do të bëhet sipas specifikimeve të kërkuara nga AK-ja;


-Pretendimi se tenderuesi tjetër "Infinit" ka ndërhyrë në dosjen e tenderit respektivisht në pozicionin 12 dhe 13 nuk qëndron pasi që oferta financiare e të njejtit është plotësisht identike me përshkrimin e çmimit të dhënë nga AK-ja; dhe

-Pretendimi se ne kemi paraqitur ndaj jush kërkesa që nuk janë paraqitur në dosjen e tenderit është poashtu i pa qëndrueshëm, sepse sqarimet janë kërkuar pikërisht në bazë të kontestimit të autorizimeve tuaja e që janë kërkesa nga dosja e për të cilat ju nuk keni arritur të dorëzoni dëshmi valide në tenderin tuaj dhe përgjegjet tuaja e as me pretendimet në këtë kërkesë. Bazuar në konstatimet paraprake kam vendosur që aktiviteti të vazhdohet sipas Vendimit dhe Njoftimit paraprak.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit